

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"EdenAr,, SH.P.K

KREU - 1

THEMELIMI-EMRI-OBJEKTI-KOHEZGJATJA –SELIA

Neni-1 -Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1-Sot, me dt 04-01-2025 ne , themeluesit, mbeshtetur me ligjin 9901 dt 14-04-2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregetare,, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emerin "EdenAr,, Sh.p.k (ketej e tutje "shoqeria,,) si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar qe do te rregullohet nga ky statut si dhe nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

2- Themeluesit e shoqerise jane:

a- Znj.Armela Xhengo atesia Luigj, lindur me 10-05-1990 ne Laç , banues ne Vlore, ne zoterim te dokumentit te identifikimit me numer J05510130T

b- Z.Artil Xhengo atesia Myzafer, lindur me 13-10-1986 ne Veliternë, banues ne Vlore, ne zoterim te dokumentit te identifikimit me numer I61013079S

Neni-2 – Objekti

Shoqeria do te kryej aktivitetin agroturizem.

Neni-3 -Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise do te jete me afat te pa caktuar.

Neni-4: Selia e shoqerise

1-Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EdenAr,, SHPK do te jete ne adresen:

Lagjja Osman Haxhiu, Rruga Vaso Shkodra, Objekt Nr.44/177/N2.

2-Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon: artil3333@live.com

KREU – 2 KAPITALI

Neni-5: Kapitali themeltar

1-Kapitali themeltar fillestar I Shoqerise eshte 100.000 (njqinde mije) leke dhe eshte i perbere nga 2 kuota.

Pjesmarrrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhteme:

a-Ortaku themelues Armela Xhengo : Zotrues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 60.000 leke qe perben 60% te kapitalit te shoqerise

b-Ortaku themelues Artil Xhengo : Zotrues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 40.000 leke qe perben 40% te kapitalit te shoqerise

2-Kapitali i ortakeve eshte ne para dhe shlyer plotesisht nga ortaket e shoqerise.

Neni-6 Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapiatalin themeltar te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve , e cila merr vendim ne te njejta kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët ne te njejtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7- Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU-3

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni-8 Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamble në përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamble në përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njejtin rend dite.

Neni-9 Menyrat e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni – 10 Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejte vote që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare,, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortaket , që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni – 11 Marrja e vendimeve

1-Asambleja e përgjithshme vendos me **tri të katërtat** e votave të zotrueseve të kapitalit , të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2-Asambleja e përgjithshme vendos **me shumicën e votave** të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni – 12 Përfshirja nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënie ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI-13 Administrimi

Administrator i Shoqërisë do të jetë Znj. Armela Xhengo , afati i emerimit është 5 vjet me të drejte ripërteritjeje. Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni-14 Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejte e detyrohet të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme ;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) Raportojnë përpara Asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- f) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilanci vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkushme brenda tre muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shes apo te disponoje ne menyre tjeter aktivet, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteteve te shoqerise qe rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria, brenda dy viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasurine, qe kane vlere me te larte se 5% te aseteteve te shoqerise , qe rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Neni-15 Pergjegjesit e administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshje, per te perballuar ne menyre individuale ose solidare sipas rastit pasojat perkatese.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

Përveç padise për shlyrjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyrjen e plote të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblese nuk mund të ndalojë ngritjen e kerkese padise kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyres.

KREU-4

VITI FINANCIAR DHE EKSPERTET

Neni-16 Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Q.K.B dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni- 17 Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilanci financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për të shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU - 5
PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni – 18 Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- 1- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- 2- me vendim të asamblese se ortakeve;
- 3- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- 4- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- 5-me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesen shtese “Shoqeri ne likujdim e siper”

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

Neni – 19 Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te ligjit 9901 dt 14-04-2012 “Per tregetetare dhe shoqerite tregetare”

Neni – 20 Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregetetare dhe shoqerite tregetare”

, Kodi civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21 Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaket

I Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

“EdenAr,, SH.P.K

Artel Xhengo

Armela Xhengo